

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike duhet të asgjësohen në një impiant i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit ,Pyjeve,dhe Administrimit të Ujrave , për kryerjen e këtij shërbimi (licenca nga Ministria e Mjedisit – fotokopje e noterizuar)
2. Subjekti duhet të ketë *Leje Mjedisore* leshuar nga Ministria e Mjedisit ,Pyjeve,dhe Administrimit të Ujrave , për qendren ku kryhet perpunimi i mbetjeve spitalore. (Leja Mjedisore nga Ministria e Mjedisit – fotokopje e noterizuar)
3. Subjekti duhet të jetë i pajisur me *Aktmiratimi Higjeno Sanitar* , leshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror.
4. Operatori ekonomik duhet të instalojë një **frigorifer** në ambientet e Spitalit Sarandë për ruajtjen e **mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lengshme dhe të ngurta** deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit.
5. Të sigurohet disinfektimi i mirë i frigoriferit dhe ambientit ku është instaluar.
6. Për transportimin e Mbetjeve duhet të disponohet nga ana e sipërmarresit të pakten një automjet në pronësi ose me qera (*te paraqitet dokumentat për mjetin*) , i cili të jetë i izoluar me rezinë dhe të ketë sinjalistikën përkatëse sipas standarteve të OBSH dhe të percaktuara në **Udhëzuesin Kombëtar të Ministrisë Shëndetësive “ Administrimi i sigurt i mbetjeve spitalore “** dhe në Rregulloren për administrimin e mbetjeve spitalore (sipas *VKM Nr 798 date 29.09.2010*) shtojca 4 .
7. Mbetjet do të merren nga sipërmarresi pranë Spitalit Sarandë me mjetin e tij të posaçëm dhe me abalazhimin përkatës në përputhje me standartet e **OBSH**, dhe **Udhëzuesin e Ministrisë Shëndetësive** për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lengshme. Të përdoren kontejnere njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmasi sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “ Për administrimin e mbetjeve spitalore “ pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III , trajtimi i mbetjeve spitalore.
8. Operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në konkurim duhet të sjellin me parë , pranë KVO së Autoritetit Prokurues , mostrat e kontejnereve plastike ose të kutive të kartonit me qeset e plastmasit sipas kërkesave standarteve për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore , të percaktuara në VKM nr 798 date 29.09.2016 si dhe në Udhëzuesin Kombëtar të " *Administrimit të sigurt të mbetjeve spitalore* "

9. Asgjesimi duhet te realizohet me nje prej metodave per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore te percaktuara ne *VKM nr 798 date 29.09.2010*, shtojca 3 e ketij *vendimi*, ku ne vecanti mbejtjet e rrezikshme spitalore anatomike, te lengshme dhe te ngurta, duhet detyrimisht te trajtohen me **Incenerim**.

10. Mbetjet e prodhuara nga Autoriteti kontraktor do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore nga spitali Sarande sipas kerkesave te entit prokurues te percaktuara me nje grafik midis paleve.



Afatet e ekzekutimit:

Prej dates se nenshkrimit te kontrates deri me 31.12.2017

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore nga spitali Sarande

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Drejtoria e Shërbimit Spiatalor Sarandë - lagja Nr 3 Rruga " Onhezmi " Sarandë

